



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.04.2016, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi nga ana e ekspertëve ndërkombëtarë z. Rainer Deville (EURALIUS) dhe z. Jon Smibert (OPDAT), të vlerësimeve/ përgjigjeve rreth komenteve dhe pyetjeve të ngritura nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për projektin kushtetues

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Eduard Halimi, Spartak Braho, Arben Ristani, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Rainer Deville – shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Jon Smibert – përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmbërëma!

Siç ishte njoftuar, le të fillojmë mbledhjen e komisionit të posaçëm parlamentar atje ku e kemi ndërprerë, pikërisht te momenti ku janë shprehur anëtarët e komisionit të posaçëm parlamentar lidhur me çështjet që do të duhet të reflektohen në përmbajtjen e projektit kushtetues në përputhje me opinionin final të Komisionit të Venecias, duke i lënë detyrën, përgjegjësinë përfaqësuesve të ekspertizës ndërkombëtare, zotit Rainer Deville, shef i misionit të EURALIUS-it, dhe zotit Jon Smibert, përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri, për të paraqitur qëndrimin dhe vlerësimin e tyre rreth pyetjeve dhe komenteve të bëra nga anëtarët e komisionit të posaçëm, siç thashë, për çështje të caktuara, që ata gjykojnë se janë me interes për t'u diskutuar, lidhur me projektin kushtetues në reflektim të rekomandimeve të opinionit final të Komisionit të Venecias.

Dy zotërinjtë shumë të respektuar, të cilët kanë marrë mbi vete një përgjegjësi të veçantë, gjë për të cilën gjej përsëri rastin t'i vlerësoj dhe t'i falënderoj përzemërsisht për këtë kontribut të jashtëzakonshëm që po japin, janë sot prezent pikërisht në respekt të kësaj vendimmarrjeje të komisionit të posaçëm parlamentar për të paraqitur atë çfarë ata çmojnë të arsyeshme se do të duhet të jetë qëndrimi rreth çështjeve të trajtuara në mbledhjet e mëparshme të komisionit parlamentar.

Një draft paraprak i përgjigjeve dhe komenteve të bëra u është shpërndarë të gjithë anëtarëve të komisionit të posaçëm parlamentar, të maxhorancës dhe të opozitës, gjithashtu, për të ndihmuar debatin për sot, pra kolegët janë të njohur me përmbajtjen e këtij dokumenti, por gjithsesi do të duhet të dëgjojmë një paraqitje të përmbledhur të çështjeve më kryesore të këtij dokumenti nga ana e zotërinjve dhe Deville.

Natyrisht, jam shumë i keqardhur për faktin se kolegët e opozitës, në vazhdim të një bojkoti politik të veprimtarisë parlamentare, nuk janë të pranishëm në këtë mbledhje të komisionit të posaçëm parlamentar, që ka të bëjë me një çështje që ka një pritshmëri të jashtëzakonshme nga qytetarët shqiptarë dhe nga partnerët ndërkombëtarë, siç është reforma në drejtësi.

Natyrisht, kjo nuk i shërben procesit ashtu siç do të duhej të ishte, dhe këtu nuk dua ta zgjas më shumë me diskutimin politik të problemit, sepse do t'i qëndroj besnik asaj çfarë duhet të bëjë kjo tavolinë më shumë sesa të diskutoj dhe të prodhoj politikisht. Kjo tavolinë është për të diskutuar në këndvështrimin kushtetues dhe ligjor për të prodhuar një projekt kushtetues të qëndrueshëm.

Shpresoj që në ditët në vijim kolegët e opozitës dhe ekspertët e tyre të vazhdojnë të jenë të përfshirë në këtë proces dhe në veprimtarinë e komisionit të posaçëm parlamentar, sepse ky nuk është një shërbim apo qëndrim ndaj maxhorancës, por duhet kuptuar si një shërbim dhe si një qëndrim ndaj pritshmërive që kanë qytetarët dhe partnerët në ushtrimin e përgjegjësisë politike, institucionale dhe qytetare të Kuvendit të Shqipërisë.

Nuk janë të pranishme mediet dhe nuk do të jenë, sepse ne do të vazhdojmë normalisht punën siç kemi vepruar edhe në mbledhjet e mëparshme, jemi në vazhdimësi të procesit dhe rregullat e lojës janë po të njëjtat, siç thashë, pa dyshim me një mungesë të rëndësishme, siç është ajo e opozitës. Por, gjithsesi, përgjegjësia ndaj detyrës që kemi, përgjegjësia ndaj qytetarëve na obligon që ta vazhdojmë procesin më tej. Kështu që do të vazhdojmë pikërisht atje ku e kemi lënë dhe për të cilën jemi mbledhur: për të dëgjuar ekspertët e nderuar në paraqitjen e qëndrimeve të tyre.

Ka ndonjë gjë nga kolegët përpara se të fillojmë? Nuk ka.

Në rregull.

Cili nga zotërinjtë do ta marrë fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Smibert? Po, faleminderit!

Zoti Smibert, fjala për ju.

Jon Smibert– *(Përthën përthyesja)* Fillimisht dua t’ju falënderoj në emër të Rainerit dhe timin, që na pritët këtu!

Këtu janë disa pyetje të rëndësishme, të cilave u duhet dhënë përgjigje dhe shpresojmë që do t’u japim përgjigjet e duhura.

E kuptojmë që roli ynë nga perspektiva ndërkombëtare është shumë i rëndësishëm për t’ju ndihmuar të merrni vendime, si një trup politik, ndaj disa nga pyetjet që kemi marrë, u jemi përgjigjur në mënyrë teknike, duke iu referuar Komisionit të Venecias ose edhe praktikave më të mira ndërkombëtare, por gjithashtu u jemi shmangur përgjigjeve të atyre pyetjeve që mund të kishin një këndvështrim paksa politik.

Disa nga pyetjet na kanë mundësuar të ecim në diskutimet me ekspertët e opozitës. Ata me të vërtetë prisnin që ne do t’u përgjigjeshim atyre pyetjeve. Por çfarë pyetjesh ishin ato? Ato përfshinin tre pjesë të reformës, që ishte *vetting*, Byroja e Hetimit dhe SPAK-u, pa përmendur pjesët e tjera. Pra, kjo kishte pak a shumë një perspektivë politike.

Dua të sqaroj fillimisht që edhe ne kemi pasur diskutimet tona me ekspertët e opozitës dhe kemi pasur diskutime edhe nga ekspertët e nivelit të lartë për të shqyrtuar pikëpamjet tona. Nga këndvështrimi ndërkombëtar, përpiqemi të jemi neutralë dhe t’ju japim përgjigjet

tona, në kuadër të praktikave më të mira ndërkombëtare. Duke pasur parasysh këtë gjë, ne kemi përgatitur këtë dokument, jo sipas rendit të pyetjeve që na erdhën, por duke përzgjedhur në fillim pyetjet e përgjithshme dhe më pas, duke kaluar nga ana kushtetuese.

Ajo që është më e rëndësishme për ta thënë shkurt që në fillim, është që dy faqet e para kanë të bëjnë me pyetjet e sistemit të përgjithshëm, si për shembull: A do të rekomandonim propozimin për institucione të reja? Kësaj pyetjeje mund t'i përgjigjemi se ky është një sistem i bazuar te *check and balance* dhe Komisioni i Venecias ra dakord me këtë gjë. Shumica e këtyre institucioneve e mbështesin njëra-tjetrën dhe ka një arsye reale për t'i pasur ato. Për këtë arsye, mendoj që si një listë institucionesh, ato kanë një kuptim dhe janë të rëndësishme për të gjithë procesin e reformës në drejtësi.

Gjithashtu, jemi pyetur shumë herë dhe kemi përfshirë dy pyetje në lidhje me *check and balance*, nëse ka korporatizëm, nëse ka rrezik për kapje politike, nëse shikojmë rrezik për konflikt interesi. Në fillim desha t'ju them se të gjitha përgjigjet paralelisht në lidhje me *check and balance* dhe për konfliktin e interesit, janë dy anë të së njëjtës monedhë. Pra, këto dy fjalë ndonjëherë përdoren shumë gjerësisht. Ne do të donim të ishim pak më të përqendruar në përgjigjen tonë.

Disa nga pyetjet shkonin te marrëdhënia midis inspektorit të lartë, Tribunalit të Disiplinës dhe Këshillit të Prokurorisë. Pra, ne menduam dhe i vendosëm disa nga përgjigjet me të kuqe në dokument, kështu që, nëse komisioni parlamentar do të hetonte për një anëtar të tribunalit, kjo do të jepte një pikëpamje të jashtme, të cilën ju nuk mund ta përdornit si diçka që po e kontrollon dikë. Ne do të sugjerorim që komisioni parlamentar të ketë edhe komisionin hetimor që t'ia kalonin çështjen e hetimeve Gjykatës Kushtetuese apo tribunalit. Kjo mund të përfshihej më lehtësisht në draftin kushtetues.

Pjesa e tretë, që besoj se është mjaft e rëndësishme për t'u diskutuar, sikurse e thashë edhe më parë, është pyetja: A duhet ta limitojmë reformën vetëm te SPAKU, te Byroja dhe te *vetting-u*?

Fillimisht, duhet të themi dy gjëra: së pari, Shqipëria ka bërë përmirësime të rëndësishme, por përsëri këto përmirësime nuk kanë qenë të mjaftueshme për arritjen e qëllimit të kësaj reforme. Duke iu referuar kapitujve XXIII dhe XXIV të *acquis*, ka edhe gjëra të tjera, të cilat janë mjaft shqetësuese brenda në sistem dhe kjo përfshin një qëllim më të gjerë të vetë reformës. Këto janë gjëra, të cilat, gjithashtu, duhet të adresohen.

Një tjetër pikë që duam të përmendim, është: A do të krijojmë vetëm një SPAK dhe prokurorinë dhe të bëjmë vetëm *vetting*, pa pasur pjesët e tjera të sistemit, që të vendosin si pjesë e reformës? Përsëri ka nevojë të bëhen ndryshime të tjera për të siguruar që SPAK-u

dhe BKH-ja janë vërtet të pavarura dhe mund ta bëjnë punën e tyre, si për shembull, ngritja e Këshillit të Prokurorisë dhe të sigurojmë që ka mënyra për t'i mbajtur këto inspektime jashtë kontrollit politik. Pra, janë bërë mjaft ndryshime, të cilat janë pjesë e një kuadri ligjor.

A është e mundur të bëjmë vetëm SPAK-un, BKH-në dhe *vetting*-un me disa ndryshime të tjera? Po, është e mundur. Kjo do të kënaqë qëllimet e gjera dhe të përgjithshme të reformës dhe mendoj se thellësia apo shtrirja e ndryshimeve nënkupton që ka pasur vërtet probleme brenda sistemit gjyqësor, të cilat duhen adresuar.

Gjithashtu, na u bë në disa mënyra edhe pyetja: Si duhet t'i zgjedhë parlamenti anëtarët e institucioneve si: anëtarët e KLD-së apo prokurorin e Përgjithshëm? Këto ishin pyetje të përgjithshme. Ne e debatuar dhe duam t'ju përgjigjemi në dy mënyra:

Njëra mënyrë është duke dhënë disa shembuj, të cilët mund të merren dhe të bëhen. Ne i kemi ndarë shpesh këta shembuj, të cilët mund të çojnë në një lloj zgjidhjeje, por këto gjëra janë diskutuar një herë dhe kanë të bëjnë më shumë me një vendim politik, i cili duhet t'i përshtatet sistemit tuaj dhe realitetit tuaj politik. Ne mund t'ju ofrojmë disa ide. Na është bërë një herë kjo pyetje dhe sigurisht ne përsëri mund t'ju japim mendimet tona për të, por përsëri duam të theksojmë që ky është një vendim politik dhe ne do të mbështesim negociatat që ju mund të bëni, por ne nuk mund t'i bëjmë ato.

Ka pasur edhe një pyetje për sa i përket Gjykatës Kushtetuese. Disa prej këtyre pyetjeve të çojnë në një lexim dhe një interpretim më teknik të tyre. Njëra nga pyetjet më të rëndësishme në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, kishte të bënte me faktin, nëse Gjykata Kushtetuese mund të gjykonte kushtetutshmërinë e ndryshimeve kushtetuese. Me fjalë të tjera, nëse do të bënim Kushtetutën, vetë Gjykata Kushtetuese duhej të thoshte nëse substanca apo gjërat thelbësore janë të drejta apo jo. Komisioni i Venecias ishte mjaft i qartë për këtë. Ai thotë se nuk ka ndonjë standard të drejtpërdrejtë që mund të vendoset.

Për sa u përket standardeve ndërkombëtare, shumë vende të tjera, e kufizojnë Gjykatën Kushtetuese, aftësinë apo kompetencat e Gjykatës Kushtetuese për ta bërë këtë gjë. Disa të tjerë thonë se ka disa shembuj shumë të paktë që Gjykata Kushtetuese mund t'i gjykojë gjërat në themel apo në substancë, sepse kjo mund të ndikojë edhe në të drejtat e pakicave, pra mund të ndikojë apo të cenojë të drejtat e minoriteteve të cilat janë të garantuara nga Konventa Europiane. Ne nuk mund të themi se është rekomanduar që t'ia japim apo jo Gjykatës Kushtetuese këtë kompetencë. Kjo nuk është zgjidhja që u bë, megjithatë është një zgjidhje tërësisht e ligjshme.

Pyetjet e tjera kanë të bëjnë me Gjykatën e Lartë, njërës prej të cilave ne dëshirojmë që t'i përgjigjemi. Kjo pyetje ndahet në dy nënpyetje: së pari, a duhet t'i lejojmë gjyqtarët që nuk kanë dalë nga Shkolla e Magjistraturës të jenë pjesë e Gjykatës së Lartë?

Së dyti, a duhet t'i lejojmë jogjyqtarët të zënë 1/5-ën e vendeve vakante.

Në fakt, nga ana logjike ne menduam se ky propozim është i pamundur, sepse duhet të keni një numër më të madh pozicionesh të hapura për ta bërë këtë gjë.

Sa gjyqtarë doni që të vijnë nga jashtë sistemit për t'u bërë pjesëtarë të gjykatave tuaja? Përsëri është një vendim politik të cilin mund ta bëni ju. Rekomandimi i BE-së ishte për një numër të vogël gjyqtarësh që vijnë nga jashtë sistemit, sepse shtetet që kanë qenë në tranzicion dhe kërkojnë të anëtarësohen në BE duan që ekspertizën ta bëjnë ata persona, që kanë njohuri veçanërisht në të Drejtën Europiane apo në fushat e tjera më të specializuara të ligjit, të cilat mund të jenë pjesë e gjyqësorit tuaj. Këta persona duhet të kenë shumë njohuri në këto fusha dhe të kenë një pozicion brenda Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, ne i grupuam edhe pyetjet për sa i përket Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku një pjesë e mirë e këtyre pyetjeve kanë të bëjnë me anëtarët jogjyqtarë brenda Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Kjo është një pjesë mjaft e rëndësishme e secilit këshill, sepse ofron transparencë, e bën këshillin më të hapur, lejon që të ketë edhe qëndrime të tjera, mënjanon korporatizmin dhe të gjitha gjërat e tjera që u përmendën më parë dhe që janë të rëndësishme.

Anëtarët jogjyqtarë do të kryejnë një funksion të rëndësishëm, por e rëndësishme është edhe mënyra se si do të zgjidhen ata, nga cilat grupe do t'i marrim, pasi duhet të zgjidhen në një mënyrë që ka kuptim brenda kontekstit të vendit tuaj.

Një pyetje tjetër lidhej me modelin se si anëtarët jogjyqtarë do t'i kryejnë funksionet e tyre, nëse do ta humbasin tërësisht karakterin e tyre profesional për të qenë pjesë e një partie politike. Në Kroaci, për shembull, anëtarët jogjyqtarë i për zgjedhin nga grupet politike. Mendoj se një drejtues e zgjedh Kryeministri dhe tjetri zgjidhet nga kryetari i opozitës.

Gjithashtu, ky person nuk është vetëm një person i zgjedhur nga një grup kandidatësh, por emërohet nga një grup politik në të njëjtën kohë. Ajo çfarë propozohet këtu, është një model i ndryshëm dhe kjo na çon në zonën e vendimeve tuaja politike.

Ne sinqerisht nuk jemi në pozitën e duhur për t'ju thënë nëse është vendim i drejtë apo jo, sepse këta persona do të zgjidhen nga forca të ndryshme politike dhe do të mbajnë ndikimet e tyre, ndaj kjo nuk është fusha jonë e ekspertizës dhe nuk mund t'ju themi dot këtë gjë.

Do të përgjigjem shumë shkurt lidhur me pyetjet e tjera dhe më pas do t'ia lë fjalën zotit Rainer, i cili do të flasë për procesin e *vettingut*, të vlerësimit të gjyqtarëve.

Ka pasur mjaft diskutime për sa i përket Inspektorit të Gjykatës së Lartë, përsëri i kthehem modelit të hetimit, për të cilin kemi folur edhe më parë, nëse do të kemi një komision hetimor parlamentar, i cili do të inspektojë edhe inspektorin dhe më pas të gjitha gjetjet do t'ia paraqesë Tribunalit të Drejtësisë. Besoj se kjo do të ishte një balancë që do të thyente të gjithë rrethin e konfliktit të interesave apo korporatistëve.

Për sa i përket çështjes së Tribunalit Disiplinor, mund të ketë ndryshime që i adresohen korporatizmit. Një mundësi e mirë do të ishte rotacioni i personave që vijnë nga fusha të tjera, ku pjesa më e madhe e tyre duhet të jenë të paktën gjyqtarë magjistratë dhe të mos jenë jashtë praktikës së gjyqësorit. “Venecia” në opinionin e saj është shprehur se nuk mund të jenë vetëm prokurorë dhe gjyqtarë, sepse në këtë mënyrë nuk do të ishte një gjykatë e vërtetë, por do të kishte vetëm karakteristikat e një gjykate. Prandaj, praktika më e mirë do të ishte që gjyqtarët të zgjidhen me short. Gjyqtarët mund të vijnë nga pjesë të tjera të sistemit, mund të zgjidhen prokurorë nga pjesë të tjera të sistemit, por të paktën të gjithë duhet të jenë magjistratë.

Gjithashtu, ne sugjeruam disa shqetësime për korporatizmin dhe për konfliktin e interesave. A do të investigojë komisioni hetimor parlamentar edhe anëtarët e tribunalit nëse ata do të kishin shkelje, apo nëse komisioni hetimor do të mendonte se ka një konflikt interesi. Mund të bëhet në të njëjtën mënyrë. Mund të kemi disa ndryshime për të shmangur që Gjykata Disiplinore të përbëhet nga anëtarë gjyqtarë, por në punën e tyre të përditshme do të jenë gjyqtarë. Nëse ata do të zgjidheshin me short dhe do të ishin anëtarë të tribunalit, atëherë mund të hetoheshin nga komisionet parlamentare, gjë që mund të sillte zgjidhjen e dikujt i cili është gjyqtar diku dhe do të bënte edhe këtë funksion. Por përsëri nuk do të shpëtonim nga ky rreth.

BKI-ja dhe SPAKU janë çështje që janë diskutuar. Në fakt, ne kemi rënë dakord që opinioni i Komisionit të Venecias duhet të dëgjohet dhe duhet të silllet me shumë detaje në Kushtetutë, për të përshkruar marrëdhënien midis SPAKU-t dhe BKI- së dhe sesi mund të përkufizohen marrëdhëniet e zyrtarëve të niveleve të larta, që mund të kenë, apo edhe raportimet që ata do të bëjnë në parlament apo në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Pra, këto do të ishin disa nga gjërat që mund të përcaktoheshin me saktësi në Kushtetutë.

Disa nga praktikat në Europë shprehin se është vetë Kushtetuta që përcakton bazën dhe çdo gjë tjetër. Komisioni i Venecias e përmendi këtë gjë dhe mendoj se është një gjë që ne mund ta rregullojmë.

Ka pasur edhe pyetje se si mund ta përshkruajmë më me detaje bashkëpunimin midis prokurorëve dhe policisë, se si prokurorët do të kontrollojnë vetveten, apo se si ata do të hetojnë vetveten për korrupsion. Përgjigjja është po, ata do ta bëjnë këtë gjë. Kjo gjë është bërë në Kroaci kur një prokuror në zyrë ka aftësinë të ndjekë penalisht edhe prokurorë të tjerë të korruptuar dhe kjo gjë ka ndodhur edhe në Rumani.

Për sa i përket marrëdhënies midis policisë dhe prokurorisë të SPAK-u, ndoshta nuk do të duhet të përcaktohet me Kushtetutë por me ligj i cili është i zbatueshëm për BKH-në dhe SPAK-un. Ne kemi një projektligj, i cili është hartuar dhe ndarë me ju dhe mund ta diskutojmë edhe më tej kur të flasim për ligjin.

Gjithashtu, ne morëm parasysh disa modele që u diskutuan nga komisioni *ad hoc* dhe është rënë dakord që të ketë një Prokuror të Përgjithshëm, i cili mund të emërohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Kjo ishte për të garantuar pavarësinë më të madhe për SPAK-un. Prandaj ky person duhet të zgjidhet me shumicë të thjeshtë, por duhet të hiqet me shumicë të cilësuar. Kjo gjë mund të bëhet me të dyja mënyrat. Mund të hiqet me shumicë të thjeshtë ose me shumicë të cilësuar. Pra, të dyja mënyrat mund të funksionojnë.

Përpara se t'ia jap fjalën zotit Rainer, dua të shtroj pyetjen se a mund të ngrihet SPAK dhe BKH-ja sa më shpejt të jetë e mundur? A mund të ngrihen ato nesër si institucione? Përgjigjja është jo, nuk mund të ngrihen.

Së pari, duhet të keni një trup që të kalojë nëpërmjet procesit të vlerësimit, me qëllim që të zgjidhni anëtarët e SPAK-ut. Pra, duhet të keni prokurorët që të verifikohen dhe të kontrollohen. Si pjesë e procesit të përzgjedhjes ky duhet të jetë një proces i pavarur.

Gjithashtu, do të preferohej që ky proces të jepte mundësinë që në këto vende të mos vendosen ata persona, të cilët nuk do të përmbushin dot edhe detyrat e vetingut sapo të vihen në këto pozicione.

Për sa i përket Byrosë Kombëtare të Hetimit, ajo duhet bërë në mënyrën e duhur, në mënyrë që këta persona të trajnohen nga FBI-ja jashtë Shqipërisë.

Gjithashtu, ne duam t'ju ndihmojmë për trajnimin e tyre në akademinë e FBI-së, që është në Virxhinia. Ky proces kërkon 3 muaj për përzgjedhjet, kontrollet dhe verifikimet e tyre dhe të çdo lloj testi tjetër të rekomandueshëm.

Për sa i përket Këshillit të Emërimeve pati mjaft pyetje. Ne duam t'ju themi se Komisioni i Venecias sugjeroi përdorimin e një organi të specializuar, pra, Këshillin e Emërimeve dhe këtë e ka përmendur disa herë. Pra, Komisioni i Venecias ka thënë se ky këshill është një garanci e rëndësishme dhe nuk do të ishte e përshtatshme nëse do ta kufizonim thjesht si një organ.

Pyetja tjetër që u ngrit ishte nëse do të kishim ende Këshill të Emërimeve. Përbërjen ndoshta mund ta ndryshojmë.

Përbërja e Këshillit të Emërimeve mund të ndryshohet nëse do të kishim një logjikë prapa saj. Pra, ai mund të ndryshohet me ndikim politik, por ju mund të thoshit se mund të përzgjidhni disa anëtarë, ose mund t'i zgjidhni këta anëtarë thjesht me short. Ka mënyra të ndryshme. Ne jemi të gatshëm që t'ju ofrojmë disa zgjidhje të mundshme në lidhje me këtë gjë.

Pyetjes nëse do të ishte e mundur që Këshilli i Emërimeve të ishte thjesht një këshill këshillues dhe jo vendimmarrës, do t'i prishej mekanizmi i thyerjes së ngërçit. Në fakt, kjo gjë u pa edhe nga Komisioni i Venecias si një gjë e pranueshme.

Gjithashtu edhe ne mendojmë se do të funksionojë, por duke parë versionet e tjera, ne nuk mund të themi që kjo do të çonte në një ngërç tjetër. Sigurisht mund të ketë edhe modele të tjera atje jashtë, por asnjeri nuk na ofroi ndonjë model që mund të funksionojë.

Po ia jap fjalën zotit Rainer, që të flasë për vettingun.

Rainer Deville - *(Përkthen përkthyesja)* Për sa i përket këtij procesi, do të fokusohem në tri pika dhe të zgjeroja pikëpamjen në lidhje me pyetjet që na janë drejtuar.

Së pari, Komisioni i Venecias ka nxjerrë disa pika teknike. Kjo shihet nga pika 78 deri te pika 84 e Komisionit të Venecias, të cilave nuk u kemi kthyer përgjigje në këtë material. Ne jemi fokusuar në përgjigjet e pyetjeve specifike për të krijuar peisazhin e duhur se çfarë duhet bërë.

Përveç opinionit të Komisionit të Venecias, hapi tjetër teknik duhet të jetë për të krijuar një version të ri të draftit, ku të reflektohen të gjitha detajet, vendimet që duhen marrë. Kjo do të ishte një pjesë e re e draftit kushtetues. Nuk duhet bërë gjithçka vetëm me ndjesi politike. Ne nuk kemi aftësinë të marrim vendime politike, por teknikisht ju mund të bazoheni në versionin e ardhshëm ose në atë aktualin, duke u mbështetur te Komisioni i Venecias, kurse pjesa tjetër që u takon përgjigjeve politike është juaja. Pra, përgjigjet që janë këtu, nuk janë gjithçka. Një pjesë e tyre kanë ngelur për hapat e tjerë në vijim.

Ne kemi marrë në konsideratë të gjitha pyetjet tuaja, një nga të cilat (ajo që reflektohet te pika 11 e përgjigjeve tona) ka të bëjë me rolin e Ministrisë së Drejtësisë. Në Komisionin Venecias kjo pyetje shfaqet gjithandej. Mund ta gjeni te pjesa e parë e pikës 31 të Komisionit të Venecias, ku Ministri i Drejtësisë dhe Presidenti nuk kanë më rol në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Pyetja që lind këtu është: Çfarë do të bëjë Ministri i Drejtësisë në këtë sistem? A duhet përmendur diku roli i tij? Këto janë pyetje politike, prandaj duhet ta ndani mendjen. Kushtetuta nuk mund të parashikojë një ligj për të gjitha ministrinë, por mund të

ketë një listë të aktiviteteve në lidhje me rolin e Ministrit të Drejtësisë, në lidhje me vendimmarrjet kushtetuese, në lidhje me ndikimin e Ministrit të Drejtësisë në aspektin administrativ. Pra, nëse doni të bëni diçka, kjo ngelet në kuadër të pyetjeve kushtetuese, kur diskutuam për sistemin e IT-së, ku përfshimë sistemin e shërbimit të provës, të prokurorisë e të tjera. Sistemi i IT-së mund të përfshihet edhe në aspektin financiar, për të përcaktuar se kush e mbështet aspektin financiar. A do të mbështesë Ministria e Financave aspektin buxhetor për të gjitha institucionet e kështu me radhë? Pra, kjo është pak e vështirë për t'u përfshirë në Kushtetutë. Nëse dëshironi të rregulloni diçka, ndoshta mund ta bashkëngjisim atë.

Pika e 3-të ka të bëjë me grupet e interesit, duke ju përfshirë ju dhe *vetting*-un, si dhe Komisionin Europin dhe ndikimin europian, gjithashtu. *Vetting* në Komisionin e Venecias ka marrë një sërë komentesh.

Vetting si një instrument i ri, është miratuar që në fillim të herës nga Komisioni i Venecias. Ka pasur një sërë pyetjesh, edhe nga BE-ja, sepse me misionet e tyre monitoruese edhe ata përfshihen aty. Komisioni European në Bruksel e ka kqyrur këtë gjë. Ata e kanë diskutuar dhe po përgatisin atë çka do të vijë më vonë për financat, që mund të fillojë menjëherë sapo të miratohen financat për projektin. Kjo gjë është e nevojshme, sepse Komisioni Monitorues Ndërkombëtar mund të ketë një rol në ndërtimin e komisioneve për të monitoruar se cili është përzgjedhur për të qenë pjesë e komisioneve dhe e niveleve të tyre.

Komisioni i Monitorimit Ndërkombëtar nuk është i pranishëm vetëm në procesin e *Vetting*-ut, por edhe në ngritjen e komisioneve, duke përfshirë elemente ndërkombëtare në të gjithë këtë sistem zinxhir. Kjo është e mundur. KE-ja është e gatshme ta bëjë këtë gjë dhe do të mobilizohet për ta realizuar atë.

Në procesin e përzgjedhjes ishte një pyetje në lidhje me Avokatin e Popullit. U diskutua nëse ky është i duhuri dhe nëse monitorimi ndërkombëtar do të ishte i domosdoshëm, por gjithsesi edhe kjo është një vendimmarrje politike. Faza e aplikimit duhet udhëhequr nga një organ neutral, përtej BE-së, i cili ka një ndikim administrativ që ndikon në ndërtimin e të gjithë sistemit. Mund të jetë dikush tjetër në vend të Avokatit të Popullit. Mund të jetë presidenti i shtetit, gjithkush, por pjesa e Avokatit të Popullit gjithsesi është miratuar si opsion.

Do të doja ta shihja nga një këndvështrim tjetër numrin 45 të pyetjeve tona, ku në opinionin e vet, Komisioni i Venecias ka kërkuar një sërë ndryshimesh, të cilat janë disi kontradiktore me njëra-tjetrën. Nuk është shumë e lehtë për t'i përfshirë dhe për t'i respektuar

të gjitha ato njëkohësisht, pra në disa raste kërkesa është shkurtuar. Mund të realizoni shumë gjëra në 5 vjet, për shembull?

Gjithashtu, pjesa e mandateve për 9 vjet, apo më gjatë, duke përfshirë në këtë moment edhe garantimet kushtetuese që të gjithë kanë të drejta kushtetuese, kërkon një krijim të ri. Si do t'i lidhim të gjitha këto elemente së bashku dhe t'i realizojmë në 5 vjet? Më pas, si do ta vazhdojmë më tej të gjithë procesin? Sigurisht, ka një sërë mundësish, që gjithsesi mbeten për t'u diskutuar dhe për t'u vendosur. Për shembull, Gjykata Kushtetuese mund të përfshijë procesin e shpejtë dhe kontrollin kushtetues, siç është propozuar. Pra, është një mundësi, por këto pyetje duhet të vendosen, dhe numri 46....

Gjithashtu, a mund të bëhet procesi i vlerësimit pak më shpejt? Kjo është një sfidë, sepse gjithçka duhet filluar dhe ndoshta nuk është një pyetje e amendamenteve kushtetuese, por ka të bëjë edhe me implementimin se si realizohet procesi, si mund ta përgatisim atë e kështu me radhë. Pra, i gjithë procesi i vlerësimit ose i gjithë aspekti kushtetues kërkon një draft të ri, ku mund të shikojmë si reflektohen këto gjëra për të dhënë një imazh të ri, si mund të shfaqen ndryshimet, sepse patjetër që do të ndodhin një sërë ndryshimesh thelbësore, është e pashmangshme.

Mendoj se kjo është përmbledhja e deklaratave dhe opinionëve të mia. Ka shumë aktivitete nga Komisioni i Venecias dhe nga Bashkimi Europian, prej të cilëve na vijnë vazhdimisht pyetje, i gjithë procesi vazhdon të gjenerojë pyetje. Kjo nuk është një përzgjedhje pyetjesh, pasi pyetje do të dalin gjatë gjithë procesit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zotërinjve të nderuar, zotit Smibert dhe zoti Deville, jo thjesht dhe vetëm për gjithë këtë proces, për gjithë punën që kanë bërë me përkushtim të jashtëzakonshëm, sepse në një kohë shumë të shkurtër janë detyruar t'u japin përgjigje jo pak, por mbi 50 pyetjeve! Natyrisht, edhe për ekspozenë e qartë që paraqitën sot në komision!

Ka pyetje të tjera nga kolegët, për ndonjë gjë që doni të sqaroni?

Urdhëroni, zoti Majko!

Pandeli Majko – Unë kam një shqetësim. Po ndaj një opinion që ka të bëjë me diskutimin e fundit, së bashku me kolegët e opozitës, për mënyrën si do të trajtohet Inspektori i Lartë i Drejtësisë në marrëdhënie me parlamentin. Ju keni vënë si mundësi që ideja e një komisioni hetimor mund të jetë e vlefshme për të trajtuar problemet që mund të ketë Inspektori i Lartë i Drejtësisë me gjyqtarë të ndryshëm. Po flas në vija të trasha, nuk po futem në specifika juridike dhe po e bëj këtë për një arsye shumë të thjeshtë.

Së pari, më mirëkuptoni! Specialistët besoj më mirëkuptojnë, sepse do t'u drejtohesha përfaqësuesve të opozitës, por nuk janë këtu. Ne ndodhemi përballë një situatë të

tillë në Kuvend, ku koncepti i komisioneve hetimore ka qenë absolutisht jo produktiv. Sot në parlament ne kemi më shumë komisione hetimore të propozuara, sesa interpelanca, që do të thotë se komisioni hetimor në Shqipëri nuk ka një eksperiencë, apo një *background*, apo nuk ka krijuar një precedent të hetimit të vërtetë parlamentar, pra, mund të konsiderohet si një mekanizëm tejet i keqpërdorur deri më sot. Prandaj, unë do të isha shumë kundër, e theksoj fjalën “shumë kundër”, futjes së një marrëdhënieje të tillë, ku një grup gjyqtarësh, për problemet që do të kenë me inspektorin e drejtësisë, t’i drejtohen parlamentit për ankesa, sepse vërtet parlamenti mund të mos ketë të drejtë ta heqë inspektorin, por mund ta diskreditojë atë në një mënyrë të tillë që të fusë në kauzë marrëdhëniet e sistemit të drejtësisë dhe kjo mund të jetë një krizë edhe më e rëndë sesa vetë largimi ose jo i inspektorit të lartë të drejtësisë, sepse goditja e tij nëpërmjet një komisioni hetimor në thelb do të jetë edhe një hetim për tribunalin disiplinor. Prandaj do të thosha se ne duhet ta shmangim absolutisht. Ju kërkoj ndjesë për përdorimin e fjalës “absolute”, sepse nuk përdoret një term i tillë në diskutimin e kësaj natyre, por mendoj se, bazuar mbi eksperiencat që ne kemi në Shqipëri, komisionet hetimore janë mekanizmi më i keqpërdorur politikisht, që do të na krijojë shumë probleme. Prandaj jam kundër përdorimit të këtij mekanizmi si mekanizëm i kontrollit, apo i krijimit të një balance midis pushtetit legjislativ dhe pushtetit të sistemit të drejtësisë.

Ana tjetër, që është diskutuar këtu, ka të bëjë me statusin e Avokatit të Popullit. Shpesh, kur ne diskutojmë institucione të tilla, siç është Avokati i Popullit, apo raste të tjera, nuk është e nevojshme që të bëj listën, kihet parasysh një person i caktuar, i cili ndodhet në atë moment në zyrë dhe nuk shikohet nga një marrëdhënie tjetër. Për shembull, nëse do të më pyesnit mua në të ardhmen e afërt, Avokati, ky që është të mbarojë mandatin, sipas meje, Avokati i Popullit në vazhdim është një institucion, i cili ka dy opsione, ose të mbesë një *outsider* i sistemit. Pra, një njeri që është dhe nuk është brenda gjithë sistemit të ndërvarësisë institucionale shtetërore dhe të mbesë në kuadrin e një gjysmë NGO-je që paguhet me paratë e buxhetit të shtetit. Unë mendoj se propozimi që Avokati i Popullit të futet në pjesën e mekanizmave të reformës në drejtësi është një hap shumë efektiv. Statusi i Avokatit të Popullit mund të shihet në ligjin e Avokatit të Popullit. Për shembull, nëse do të më pyesnin mua dhe nëse do të vendosej kushti që Avokati i ardhshëm i Popullit të ketë një *background* thuajse të detyrueshëm, të jetë ish-anëtar i Gjykatës së Lartë apo i Gjykatës Kushtetuese, kjo do të krijonte edhe një situatë tjetër të të parit edhe nga pikëpamja e ekspertizës apo marrëdhënies së Avokatit të Popullit në marrëdhënie me institucionet e tjera. Megjithatë, kjo është një çështje që do të kërkonte diskutim me kolegët e opozitës, por ata nuk janë sot këtu të pranishëm, kështu që ne jemi të detyruar të bëjmë një diskutim pa prezencën e tyre.

Nëse do të më lejoni, ashtu siç bëri edhe kolegu Xhafaj, dua t'ju falënderoj për të gjitha përgjigjet që keni dhënë, si dhe do t'i propozoj komisionit që t'i lajmërojmë edhe kolegët e opozitës për të thënë se tani është koha për të filluar diskutimin nen për nen. Pra, nuk kemi se çfarë të diskutojmë më tepër nga pikëpamja e parimeve të përgjithshme, pasi edhe procedura është e një natyre të tillë shteruese, jemi drejt fundit dhe duhet të fillojmë diskutimin nen për nen, në fund të fundit, për këtë arsye parlamenti na ka caktuar në këtë komision.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Dëshironi që t'i mbani shënim të gjitha pyetjet apo rast pas rasti?

(Diskutime pa mikrofon.)

Rainer Deville – *(Përkthen përkthyesja)* Faleminderit!

Sigurisht, e kuptoj shqetësimin tuaj për të pasur një organ legjislativ, i cili do të kontrollohet nga dikush tjetër. Ne në fakt kemi pasur komisione hetimore legjislative dhe shpeshherë ato mund të mos japin ndonjë vendim, mund të shpenzojnë shumë kohë, të dëgjojnë dëshmi për orë të tëra dhe përsëri nuk janë frytdhënëse. Në fakt, ky është një shqetësim i vërtetë, të cilin ne e kemi diskutuar. Gjithashtu dhe çështja që ne kishim me çdonjërin prej këtyre nuk ka një vend aq të madh në institucionet e kufizuara. Nëse ju e shihni se cilat institucione të tjera mund ta thyejnë dhe ta prishin këtë rreth vicioz, nëse ofroni Avokatin e Popullit si një *watchdog* potencial të sistemit, që të kryejë hetimet dhe të ketë një inspektor dytësor të gjyqësorit, atëherë ju filloni në këtë mënyrë të keni gjithnjë më shumë kontrollues që kontrollojnë kontrolluesit. Pra, i bie që pastaj do të kemi se kush kontrollon kë dhe kush e kontrollon kontrolluesin. Ky është një shqetësim që qëndron dhe unë e kuptoj atë se çfarë ti do të thuash me këtë. Kjo është historia e parlamentit këtu, që komisionet hetimore kanë qenë gjithmonë një përvojë e vështirë dhe sigurisht që është diçka, të cilën ne e marrim parasysh në përgjigjet tona.

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasilika Hysi - Unë kam një pyetje lidhur me tribunalin disiplinor, më konkretisht në lidhje me komentit që është bërë në paragrafin 19, të materialit të paraqitur. Lidhur me pyetjen: a është e këshillueshme që të ketë anëtarë jogjyqtarë në përbërje të tribunalit, ju thoni se një zgjidhje mund të ishte që të ketë dy anëtarë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe një prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të zgjedhur me short për një vit kalendarik. Në mendimin tuaj, a ekziston rreziku që këta persona, për shkak se janë në fillim të karrierës dhe në vitet në vazhdim kërkojnë të promovohen, mund të krijojnë një farë

korporatizmi, pra të mos jenë kaq të lirë në marrjen e vendimeve të tyre, sepse mendojnë se kanë një karrierë të gjatë plus shkallën e kualifikimit të tyre? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë ka të bëjë me pikën 12. A është e këshillueshme që të reduktohet numri i anëtarëve jomagjistratë? Ju keni sugjeruar se mund të jetë. Pra, na e keni lënë neve si klasë politike që të hiqet përfaqësuesi i shoqërisë civile dhe një gjyqtar, kështu që numri total do të zbriste nga 9 në 5 gjyqtarë dhe 4 jogjyqtarë dhe prokurorë. Përse keni përzgjedhur pikërisht përfaqësuesin e shoqërisë civile, thjesht sepse është i vështirë për t'u përcaktuar apo për të zvogëluar numrin e përfaqësuesve? Nëse e bëjmë këtë gjë, atëherë do të vazhdojë që kryesimin ta ketë përfaqësuesi jomagjistrat në këtë këshill?

Pyetja e tretë, e cila lidhet pak edhe me shqetësimin e kolegut Majko, për komisionet hetimore parlamentare, a mendoni, duke pasur parasysh përvojën e komisioneve hetimore dhe debatin që ne po bëjmë, ligji faktikisht ka probleme, nëse do ta lëmë komisionin hetimor parlamentar, se duhet të ndërhyjmë që të bëjmë ndryshime për të shmangur atë situatë që ka sot? Ne e dimë shumë mirë që asnjë komision hetimor parlamentar nuk ka përfunduar me një raport të përbashkët, por gjithmonë problemet janë politizuar dhe më shumë kanë bërë dëm sesa e kanë zgjidhur situatën.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush do të përgjigjet?

Zoti Rainer!

Rainer Deville – *(Përkthen përkthyesja)* Çdo gjë që ju e gjeni me ngjyrë të kuqe, është thjesht një mundësi që ju duhet ta merrni si vendim. Është e shkruar me ngjyrë të kuqe, por nuk do të thotë se ky është opsioni që ju duhet të merrni. Është një alternativë një opsion, i cili doli gjatë diskutimit. Përgjigjet tona mund të jenë kundër opinionit të Komisionit të Venecias, apo komplet kundër standardeve tuaja, por nuk do të thotë që kjo është e vetmja përgjigje, nuk do të thotë që këto përgjigje janë më të mençurat, nuk do të thotë që duhet të zgjedhësh këtë. Ne ju themi se kjo është thjesht një alternativë të cilën ne e hedhim për diskutim, sepse nuk jemi ne ata që i marrim vendimet. Vendimet merren nga politikanët. Ne jemi thjesht për të ofruar një alternativë, të hartojmë disa zgjidhje, por nëse është e shkruar me të kuqe, thjesht i jemi referuar diskutimeve nëse është e mundur ose jo. Nëse është e mundur që në Tribunalin Disiplinor të shtoni disa persona, përveç atyre të dyshuarve të zakonshëm, pra disa persona të rinj që i përzgjedhim ne, po është e mundur, mund të ndodhë kjo gjë. A besoni ju se kjo mund të jetë diçka e mençur apo duhet të ndodhë kështu? Atëherë, ky është vendim që duhet ta merrni ju. Nëse e shikoni të gjithë panoramën, një gjyqtari të

pavarur në sistemin tonë, në fakt kemi persona të cilët janë të rinj dhe mund ta bëjnë këtë gjë, për shembull si pjesë e Tribunalit Disiplinor, sepse kemi edhe Apelin pas tyre. Gjithashtu, mund të jetë edhe pyetje e një dhome. Nëse ata në njëfarë mënyre janë të ndikuar nga ata persona që kanë qenë aty për një kohë më të gjatë, nuk është diçka e gabuar teorikisht. Nëse ju do të zgjidhni diçka, pra varet nga ju çfarë do të dëshironit të zgjidhni. Sigurisht, ju mund të zgjidhni. Në lidhje me pyetjen tuaj, nëse është e mundur ta bëjmë këtë gjë, pse jo, ju thjesht nuk duhet të jeni në kundërshtim me standardet e Komisionit të Venecias, kështu që ju mund ta bëni këtë gjë.

Për sa u përket anëtarëve të këshillave, është përsëri me ngjyrë të kuqe. Kjo do të thotë që ju jeni ata që do t'i merrni vendimet, jo ne. Ne nuk i marrim vendimet. Nuk ka asnjë standard evropian që ju kërkon të keni ekzaktësisht, le të themi 11 persona. Jo. Nuk duhet të jetë numër tek apo çift, por mund të keni 13, 17 19, ose mund të keni dhe vetëm 9. Po sigurisht mund të keni vetëm 9. Nëse ju e merrni vendim politik që duhet të jenë 9 persona, atëherë ajo që ju duhet të bëni është të ndryshoni edhe pjesën tjetër të sistemit. Nëse ju keni 5 plus 4, sigurisht është një mundësi që ekziston. Por kjo do të thotë se nëse në vend të 5 anëtarëve, mund të kesh vetëm 4 jashtë sistemit, është vendimi juaj se cilin do të hiqni. Shoqëria civile, në fakt, ka vështirësi për implementimin e legjislacionit, sepse nuk është aq shumë e organizuar si një dhomë. Nëse ti shkon në një dhomë, te Dhoma e Noterisë për shembull, ata kanë një strukturë perfekte, që është e vendosur. Ata kanë zyrat dhe çdo gjë.

Gjithashtu, ju mund të mendoni që ta ndërtoni këtë në mënyrë komplet të ndryshme. Nuk është diçka që ne sugjerojmë se duhet ta merrni patjetër këtë alternativë. Ajo çfarë ne themi në fakt, është se nëse ju vendosni në këtë mënyrë, atëherë ju nuk do të bini në kundërshtim me ndonjë nga kërkesat e Komisionit të Venecias, sepse Komisioni i Venecias nuk përcakton ndonjë numër të saktë 11, 12, 13, 9 dhe ne nuk ju themi që duhet të keni këtë apo atë model. Këtu më vjen keq, tani e keni ju radhën që të zgjidhni. Ju duhet të vendosni për këto pyetje me komisionin tuaj parlamentar.

Të njëjtën përgjigje mund t'ju them edhe për atë që është pak e vështirë të caktojme se kush do të kryejë hetimet, sepse nëse ju doni të përzgjidhni një opsion, një alternativë tjetër se nuk ju pëlqen kjo alternativë, ne përsëri do t'ju themi: po, ju mund të gjeni, mos merrni dikë që është pjesë e sistemit. Pra, ky është shqetësimi ynë. Ju duhet të gjeni dikë që nuk është brenda sistemit. Nuk është Ministri i Drejtësisë, sepse përndryshe do të ishte i ndikuar. Por nëse mund të thoni që hetuesi mund të zgjidhet nga komisioni parlamentar dhe hetuesi duhet të ketë këto kritere, të cilat janë të përcaktuara me ligj. Mbase mund të mos jetë një komision parlamentar hetues, por ju mund të zgjidhni dikë, i cili mund të përmbushë këto

standarde apo këto kritere. Kjo do të ishte edhe më e ndërlikuar, sepse do të kishte një procedurë të ndryshme. Duhet të krijonit diçka për implementimin saj. Sigurisht, ju mund ta bëni këtë gjë. Por në këtë fazë nuk mund të thoni thjesht: nuk na pëlqen. Por duhet të keni një alternativë tjetër dhe ne thjesht ju sugjerojmë dhe më pas ju mund të zgjidhni këdo, ju mund të thoni se e duam Ministrin e Drejtësisë.

Pra, ka shumë alternativa. Edhe një herë po jua përsëris: ajo që është me të kuqe nuk do të thotë që ju kërkohet ju që ta bëni me doemos. Pra, është vendimi juaj në fund që ka rëndësi. Jon e tha mjaft qartë. Ne nuk është se po marrim vendimet politike, kjo është puna juaj.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ju mirëkuptova, është çështje që ju e keni ngritur për diskutim dhe mbetet në vullnetin e ligjvënësit të zgjedhë.

Faleminderit!

Jon Smibert –(Përkthen përkthyesja) Unë dua të bëj disa komente të shkurtra.

Për sa i përket numrit të anëtarëve jogjyqtarë, ne ju themi se pyetja qëndron këtu, në fakt, a mund ta bëni këtë gjë? Po, mund ta bëni këtë gjë. Ne nuk e morëm shoqërinë civile për ndonjë arsye të veçantë, është thjesht e vetmja, e cila nuk ka strukturë për të zgjedhur një person. Shpeshherë Komisioni i Venecias kërkon një gamë të gjerë përdoruesish të sistemit që të jenë anëtarë të këtyre institucioneve. Në fakt, të kemi numrin 11, është diçka që ne menduam se do të kishte një balancë të mirë, sepse do të kishim përfshirjen e një përfaqësimi të të gjithë përdoruesve të sistemit dhe do të ishte një përfaqësim edhe nga gjyqtarët edhe nga prokurorët.

Gjëja tjetër që dua të them në lidhje me tribunalin dhe pyetjen e hetimit brenda parlamentit, pra nëse do të ishte e drejtë apo e padrejtë, e përshtatshme, apo e papërshtatshme për tribunalin që të kishte gjyqtarë që vinin nga instancat më të ulta apo prokurorë që vinin nga instanca më të ulta, në disa vende ku ata i kanë këta anëtarë, qëllimi nuk është që ata thjesht të jenë të vjetër, të mençur, por personat që do të marrin vendime, gjithashtu, duhet të dëgjohet edhe zëri i kolegëve që janë pjesë e procesit. Pra, vendimi nuk është thjesht për personat që e kanë bërë këtë punë për 30 vjet dhe tani t'u themi atyre se kanë bërë një gabim, por duhet të ketë një shumëllojshmëri këndvështrimesh dhe opinionesh. Sigurisht, duhet të jetë edhe një balancë, por një balancë midis personave që janë mjaft të vjetër, por edhe atyre që janë më të rinj. Pra, mendoj se ka gjithmonë një ligjshmëri, ekziston kjo gjë në disa sisteme të cilët gjenerojnë, operojnë në më shumë se në një trupë gjykuese, ku ne thjesht zgjedhim disa magistratë që marrin disa vendime në mënyrë rastësore, në rrethana të ndryshme. Është më e vështirë për ta ngritur si organ apo si mundësi. Gjithashtu, kjo mund

të jetë një përgjigje që kërkon më shumë zhvillim për sa i përket thyerjes së këtij rrethi vicioz. Mbase parlamenti nuk është në proces që mund të ngrejë njëfarë jurie. Pra, përsëri kjo na çon në korporatizëm dhe nuk e di se cilat do të ishin rregullat për komisionet hetimore këtu, nëse do të ketë hapësirë për të përmirësuar këtë si pjesë e strukturës.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj -Ka pyetje? Po, zonja Caka.

Silva Caka – Kam një pyetje shumë të shkurtër, për sa i përket një prej sugjerimeve të bëra në pikën 11 të materialit që kemi përpara. Në fakt, jam shumë kurioze të di nëse në përgjegjësinë e përgjithshme, që është propozuar për të pasur ministri i drejtësisë mbi strukturat e teknologjisë së informacionit për gjykatat, po shërbimi i strukturave gjyqësore dhe prokurorisë a është parashikuar në të, apo e keni lënë rolin e ministrit të drejtësisë vetëm në suazën e teknologjisë së informacionit për gjykatat dhe prokurorinë?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ideja është për të pasur edhe shërbimet e tjera.

Rainer Deville – *(Përkthen përkthyesja)* E kuptojmë këtë pyetje. Nuk është përcaktuar. Një nga pyetjet tuaja ishte që nëse roli i Ministrit të Drejtësisë duhet të rregullohet disi. Por nuk e keni përcaktuar tamam se cili do të jetë roli i ministrit, si do të aplikohet. Komisioni i Venecias e përcakton qartë se roli i ministrit është tashmë shumë i kufizuar në këtë ndarje të qartë të pushteteve. Ministri humbet një sërë funksionesh, duke përfshirë të gjitha procedurat e përfshira. Ne e diskutuam, nuk do të jetë pjesë e Këshillit të Lartë. Pra, lind edhe pika se çfarë do të bëjë ministri i Drejtësisë? Cili do të jetë roli i tij? Pyetja juaj ka të bëjë me ndikimin e ministrit të Drejtësisë në gjykata dhe në sistemin e prokurorisë. Zyra e prokurorisë mbetet ashtu siç është sot, një institucion i pavarur, i rregulluar nga Kushtetuta, me pjesën teknike të zyrave të specializuara, por nuk është nën ndikimin e ministrit të Drejtësisë, inspektimi nuk është nën ministrin e Drejtësisë. Për këtë duhet të vendosni ju se ku e shikoni rolin e ministrit të Drejtësisë në të gjithë sistemin operativ. Përgjigja jonë është që ministri i drejtësisë nuk duhet të ndërhyjë në aktivitetet ditore dhe as në sistemin e prokurorisë. Nëse shikoni nga pikëpamja administrative se cili do të jetë aspekti administrativ për të gjithë gjyqësorin, atëherë mund të mendoni se ndoshta dëshironi që të keni një rol që mund të mos bëhet nga këshilli i prokurorisë për gjyqtarët. Në projektin tonë ne kemi çështjen e IT-së në institucionet e drejtësisë dhe vëmë re se çdo institucion i tillë vepron në një sistem të ndarë, gjë e cila nuk është shumë e gjetur, e mençur. Ky është thjesht një shembull ku mund të mendoni se cili është aktiviteti i përgjithshëm i ministrit të drejtësisë.

Por ministri i drejtësisë në të vërtetë është mënjanuar disi nga Komisioni i Venecias për t'i dhënë më shumë fuqi sistemit të gjyqësorit, si një fuqi e tretë në shtet.

Fatmir Xhafaj – Dhe unë kam disa pyetje. Po e filloj nga një pyetje që është bërë shumë kohët e fundit edhe këtu në komision. Ka një përgjigje, por nuk mendoj se është e qartë dhe shteruese.

Ne me projektin e ri kushtetues kemi një arkitekturë të re të sistemit me institucione ekzistuese që ruajnë vendin e tyre, por ridimensionojnë pozicionet me institucione ekzistuese apo që ngrihen në pozicion kushtetues, si dhe me institucione tërësisht të reja. Kjo arkitekturë e re e sistemit, të cilën e mbështet fort, së paku nga dy opinionet e veta, nga opinionin final dhe Komisioni i Venecias, në vlerësimin tuaj a është e plotë? Nëse do të tentonim të ndryshonim një prej këtyre komponentëve, a mund ta cenonim të gjithë arkitekturën e sistemit?

Pyetja tjetër ka të bëjë me Gjykatën e Lartë. Përgjigja e dhënë nuk është shumë e qartë, por evazive, sepse, nëse do t'i përmbahem logjikës që keni thënë ju, që e parashtruat edhe këtu se çfarë janë me të kuqe janë çështje që janë të diskutueshme, që mund të merren në vlerësim ose jo nga ana jonë, më duhet të them se Gjykata e Lartë Administrative është pjesë e arkitekturës së re të sistemit nga njëra anë është dhe një kërkesë e biznesit, nga ana tjetër. Ne themi se këto ndryshime thelbësore në reformën e drejtësisë, ndër të tjera, janë edhe një mbështetje e fortë ndaj biznesit. Gjykimi i çështjeve që lidhen me të zë një vend të rëndësishëm dhe shpresojmë të japë një impakt pozitiv.

Në mënyrën se si është thënë këtu, është e diskutueshme, apo është ajo që duhet të kuptojmë në një version tjetër, që bëhet fjalë se përkohësisht do të ketë një kolegji të posaçëm administrativ brenda Gjykatës së Lartë, ndërsa në 2020-ën do të duhet të kemi Gjykatën e Lartë Administrative, për të mbyllur të gjitha shkallët e gjykimit administrativ, nga njëra anë për të dhënë cilësi, nga ana tjetër edhe shpejtësi dhe eficiencë në gjykimin administrativ.

Së treti, ka të bëjë me pikën 12, që trajtoi edhe kolegja Hysi. Është një opsion. Edhe unë jam dakord me ju, që është pak sa e vështirë, për mënyrën se si është organizuar shoqëria civile, për të zgjedhur përfaqësuesin e saj. Por, duke pasur vetëm përfaqësues të grupeve të interesit, siç janë avokatët, noterët e të tjerë, a nuk do të ishte më mirë që një përfaqësues i shoqërisë civile, si komponente e grupeve në nevojë, grupeve që kanë nevojë për më shumë mbështetje, që kanë nevojë për shumë akses në sistem, për asistencë. Kauza të kësaj natyre, shoqëria civile i ka kauzat e saj, që shpesh kanë të bëjnë me garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve.

Jam dakord, por në këto kushte, a mund të gjejmë një formulë që ta ruajmë? Sepse, të themi të drejtën, edhe mua më pëlqen ngushtimi i numrit, sepse më pak njerëz, kosto më e vogël e të tjera, është gjë pozitive, por ndoshta mund të gjenim një zgjidhje. Sidomos te Këshilli i Lartë Gjyqësor, por edhe te prokuroria, e njëjta gjë është.

Shqetësimi tjetër lidhet me pikën 13, ku unë, që të jem i sigurtë, nuk ndaj të njëjtin vlerësim me ju. Për të mbrojtur pikëpamjen e parashtruar, ju morët si argument shembullin kroat. Në rregull, por ama ka një diferencë. Në rastin e Kroacisë dhe të Maltës, edhe përzgjedhja, edhe zgjedhja janë politike. Edhe përzgjedhja bëhet mbi kriteret e mbi kërkesat politike. Pra, i përzgjedh dhe i emëron politika. Mos t'i hyjmë faktit se Kroacia ka një deputet të maxhorancës dhe një deputet të opozitës, një të qeverisë dhe një të opozitës. Kjo do të thotë se ata, praktikisht, janë me burim politik, nga rrethi i politikës. Në rastin për të cilin ne flasim, ata përzgjidhen si profesionistë, më falni, kandidojnë si profesionistë, kanë kriteret si profesionistë të fushave, përzgjidhen si profesionistë dhe nga institucione për profesionistët e fushës, dhe emërohen politikisht.

Mos jemi në një diferencë shumë të madhe këtu? Sepse, e marrim si argument, mua më duket se shembulli i Kroacisë dhe i Maltës shkon në të kundërt me atë çfarë ju keni dashur të argumentoni këtu.

Unë e kuptoj nevojën që ka, për të pasur konsensus, por jo çdo argument mund t'i shërbejë konsensusit, qoftë edhe modele të gatshme.

Tjetër, pika 24. I keni dhënë përgjigje pyetjeve që lidhen me SPAK-un dhe BK-në: "A është e këshillueshme, që Kushtetuta të parashikojë në mënyrë më specifike rolin dhe funksionet e SPAK-ut dhe BK-së".

Këtu, në përgjigje, nuk është shumë e qartë për mua. Përgjigja ka të bëjë me nevojën për ta zgjeruar parashikimin kushtetues aktual, që kemi, apo e keni fjalën për të parashikuar ligjin zbatues, për ta vënë në mënyrë të detajuar edhe në ligjin zbatues? Nëse do të ishte kjo e dyta, përgjigja është e qartë.

Pyetja tjetër lidhet me 37-ën. A mund të ma sqaroni më mirë çështjen e mekanizmit të shortit, për thyerjen e ngërçit që krijohet në këtë rast? Siç e kuptoj unë, nëse ne do të bënim hedhje shorti, mbasi kemi bërë një renditje të meritës, nga këshilli i emërimeve, ç'kuptim ka renditja? Atëherë ne nuk do të kishim nevojë për këtë gjë. ka bërë një renditje këshilli i emërimeve. Këshilli i emërimeve ka bërë një renditje prioritare. Përse duhet të hedhim short, për të zgjidhur ngërçin?

Pika 47, e parë me pikën 51. Konkretisht, çfarë keni dashur të thoni në lidhje me çështjen e këshilltarëve ligjorë? Ku është shqetësimi? Unë nuk e di që të jetë vënë në diskutim çështja se duhet të testohen në Shkollën e Magjistraturës.

Këto kisha për momentin, sepse s' më lind ndonjë dëshirë për pyetje të re, derisa ju t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve.

Po, zoti Smibert apo zoti Rainer, zoti Deville.

Zoti Smibert, po.

Jon Smibert – (*Përkthen përkthyesja*) Do të përpiqem të përgjigjem sa më mirë të mundem.

Pyetja e parë përqendrohet për të sqaruar më tej nëse e shikojmë këtë si një sistem të plotë, nëse disa gjëra mund të hiqen. Pjesa e dytë e kësaj pyetjeje është një nga ato gjërat që...

Ne Gjykatën e Lartë Administrative e kemi filluar duke u bazuar te Komisioni i Venecias. Gjykata e Lartë Administrative që përfundon në vitin 2020 e shikon të gjithë sistemin si një sistem *check and balance*. Duhet të shikojmë Gjykatën e Lartë Administrative si pjesë të saj, por jo si një pjesë integrale të saj deri sa të krijohet në vitin 2010.

Në lidhje me pyetjen e parë, shikojmë se është dorëzuar te Komisioni i Venecias. Ajo që është dorëzuar është një sistem i plotë mbështetës që merr atë çfarë ka në Shqipëri, ndërton edhe disa pjesë të tjera dhe përpiqet të vendosë sistemet *check and balance*, hapat e duhur për të vëzhguar njëri-tjetrin, pa u bërë mbivëshgues me njëri-tjetrin. Pasi hiqni pak elemente nga njëri-tjetri, atëherë do të keni pak kontrollues që do të mbeten dhe sistemet *check and balance* bëhen më pak, edhe më pak. Mendojmë se ajo që i është dorëzuar Komisionit të Venecias është një kompromis për atë që është e mundur në Shqipëri për të ruajtur sistemin e mirë *check and balance* dhe vetëkontrollin për ta bërë sistemin më të mirë.

Siç duket në Shqipëri tani është nevoja për të rregulluar disa gjëra. Nëse i lëmë gjërat kështu siç janë, do të ishte e vështirë ta quanin këtë një reformë. Megjithatë në varësi sesa e madhe, se çfarë përmasash doni t'i jepni ju fjalës reformë, nuk do të thotë se nëse bëni diçka të vogël nuk është e mirë, atëherë na duhet një sistem i plotë.

Gjëja e dytë që ka të bëjë me Gjykatën e Lartë Administrative, mund të them se nuk mund të flasim më shumë detaje, sepse nuk jam marrë shumë me këtë gjatë këtij procesi. Për komunitetin e biznesit si përfaqësues i misionit e kuptojmë që një nga shqetësimet ka të bëjë me kapacitetet për të pasur një sistem gjykate të mirë, funksional, administrativ në të gjitha aspektet. Nga ky aspekt nëse Gjykata e Lartë Administrative nga vitit 2010 dhe në vijim rregullon pjesën e ligjeve, e bën këtë edhe më efikase, i bën çështjet të lëvizin më shpejt. Kjo

do të ishte e mirë dhe ne duhet ta mbështesim këtë gjë, por nuk mund të flas për këtë gjë, pa pasur shumë elemente, pa pasur shumë të dhëna. Ka shtete europiane që kanë gjykatat e larta administrative dhe të tjera që nuk i kanë ato. Pra, nuk mund të flas për këtë gjë qartazi.

Gjëja e tretë për të cilën ju pyetën nëse ne duhet ta mbajmë shoqërinë civile në numrin e anëtarëve jo gjyqtarë. E përdorim këtë për të ilustruar, që po: mund të hiqen për një arsye të mirë, po në të njëjtën mënyrë mund të hiqen edhe noterët ose dikush tjetër. Ne zgjodhëm thjesht një, sepse janë dhomat për gjithçka, por nga pikëpamja jonë gjithmonë mbështesim fuqizimin e shoqërisë civile, veçanërisht për viktimat, për të drejtat e tyre dhe çdo lloj të drejte që ka të bëjë me sistemin e drejtësisë. Kështu ndodh në shumicën e vendeve, nëse është dikush që përfaqëson njerëzit e vendit, nuk ka asgjë që t'i mbajnë ata. Është thjesht një ilustrim për atë që donim të thoshim për të arritur numrin pesë plus katër në sistem. Gjithashtu donim të shprehnim se nuk duam që ky numër të reduktohet. Ndoshta ka shumë prokurorë, gjykatës dhe kjo gjë do të na çonte në korporatizëm. Ne duam të gjejmë një balancë midis të dyja palëve. Nuk ka të bëjë me reduktimin e një grupi të caktuar, por për të siguruar të ilustrojmë që balanca do të ruhet, veçanërisht nëse ecni drejt tubave më të vegjël, e më të vegjël.

Kalojmë te pyetja për rolin dhe funksionimin e SPAK-ut, BKH-së dhe parashikimi i tyre më specifik në Kushtetutë. Nëse do të ofronim një shembull, i cili mund të përfshihej në disa nga nenet e Kushtetutës për të sqaruar përzgjedhjen, kryetarin e SPAK-ut ose rolin e BKH-së, veçanërisht për SPAK-un, janë gjëra që mund të shpjegon, të zgjerohen në Kushtetutë me më shumë detaje. Mendoj se janë praktika më e mirë. Në pjesën e Komisionit të Venecias është të përshkruajë fuqitë dhe organet kushtetuese dhe kjo gjë duhet të përshkruhet në ligj me më shumë detaje. Kjo mendoj se nuk dëmton, veçanërisht në Kushtetutë, ku një organ i pavarur shkon kundër pushteteve, por kjo hyn në debatin që ndodhet në shumë vende, se sa shumë detaje duhet të futen në Kushtetutë dhe pse. Komisioni i Venecias donte më shumë detaje. Ne kemi menduar se si do të dukeshin këto detaje në Kushtetutë dhe patjetër jemi të hapur për ta ndarë këtë gjë në komisionin *ad-hoc*.

Gjithashtu pyetët për numrin 37, për mekanizmat e shortit dhe për thyerjen e ngërçit dhe si mund të ndodhë kjo gjë. Shqetësimi këtu nuk është se cili do të ishte sistemi më i përkryer, por nëse do të ketë një kompromis i cili mund t'i akomodonte të dyja palët dhe në të njëjtën kohë të funksiononte dhe të ishte brenda një standardi kombëtar. Kjo ishte diçka të cilën ne e menduam, për këtë arsye është me ngjyrë të kuqe, sepse ju mund t'i rankoni të tre personat dhe mund të thoni në publik: kjo është zgjedhja jonë e parë, e dyta apo e treta. Mund të thoni se disa nga shqetësimet tuaja mund të jenë sesi mund ta apeloni këtë vendim. Nuk ka

një proces apelimi të këtij vendimi. Nëse ju do ta apeloni, do të vazhdoni me një proces ku do të zvarrisnit çdo gjë. Pra, nëse do ta kishit mekanizimin e thyerjes së ngërçit, ju, tashmë, i keni zgjedhur tre persona që mund të jenë të kualifikuar. Ju i kenë thënë publikut se këto janë përzgjedhjet më të mira për qëllimin e këtij organi të specializuar dhe ju jeni duke parazgjedhur me short. Në këtë mënyrë po thyheni ngërçin, sepse ju nuk mund ta apeloni “zgjedhjen e kuqe”, por, në qoftë se ju thjesht do të paraqisni një listë të këtyre tre personave, pra vetëm tre emra dhe do të thoni se kjo është zgjedhja jonë e parë këshilluese, por për mekanizmin e thyerjes së ngërçit ne thjesht kemi zgjedhur personin numër 2, i cili mund të përzgjidhet, është parlamenti ai që mund të jetë i aftë për ta dhënë këtë përgjigje. Mendoj se kjo është mënyra si i jemi përgjigjur ne.

Dua të sqaroj që në fillim së në të gjithë këtë proces, i cili është duke vazhduar për më shumë se 1 vit e gjysmë, ne kemi pasur funksione të ndryshme, dhe aktivitete të ndryshme. Kur ne e filluam këtë proces më analizime në kuadër të reformës, kur analizuam strategjinë dhe draftin e parë, ne ishim anëtarë të grupeve të punës dhe së bashku me ndërkombëtarë të tjerë, por edhe me grupet shqiptare të interesit dhe përfaqësues të institucioneve shqiptare kemi diskutuar me kolegët tanë se cilat do të ishin zgjidhjet më të përshtatshme, se cila do të ishte zgjidhja e cila do t’i përshtatej më mirë Shqipërisë, që ajo të përmbushte standardet ndërkombëtare. Rezultati i kësaj është drafti që ne kemi sjellë së bashku me 100-200 persona që kanë qenë pjesë e tryezave të rrumbullakëta që kemi zhvilluar. Funkcioni që jemi këtu me këtë kapacitet dhe me Komisionin e Venecias është paksa më ndryshe, sepse ne duhet të themi se cili është opinionin e Komisionit të Venecias. Nëse ju mund të na jepni alternativa ndaj këtij opinionin, pra nëse ai është në kundërshtim me këtë opinion apo do të ishte një pengesë ndaj këtij opinionin, është një opsion që ju duhet ta merrni vetë politikisht një vendim dhe të thoni. Nëse është një vendim i zgjuar dhe nëse i përshtatet më mirë sistemit dhe nëse e shikoni Gjykatën e Lartë Administrative, propozimi ishte që të keni një gjykatë të tillë, por në kohën e duhur. A është e mundur të mos e kemi një gjykatë të tillë? Përgjigjja është po, pra është e mundur. Ju këtë gjë mund ta vendosni pa thyer ndonjë standard ndërkombëtar, që të vazhdoni një Gjykatë të Lartë që ka një dhomë të specializuar për çështjet administrative. Ju i keni diskutuar të gjitha pikat pro dhe kundër kësaj gjëje. Kjo nuk ishte diçka që doli nga ekspertët dhe nga diskutimet që kemi bërë ne së bashku, por politikisht jeni ju ata që merrni vendimet në parlament dhe ju duhet t’i merrni këto vendime. Në këtë mënyrë ju nuk jeni në kundërshtim me Komisionin e Venecias apo me standardet. E njëjta gjë vlen edhe për shoqërinë civile për këshillin. Në fakt, propozimi ishte të kishim 11 persona për të përfshirë të gjitha palët e interesuara. Nëse ju bini dakord ta bëni ndryshe këtë gjë dhe të hiqni një

shtyllë, kjo është e mundur. Nga këndvështrimi i opinionit të “Venecias” mbase nuk do të ishte edhe aq e këndshme, por është e pranueshme, por mund ta bëni këtë gjë. Ne i jemi përgjigjur kësaj pyetjeje. Nëse ju doni ta bëni, nëse ju duhet ta bëni këtë gjë, atëherë ky mbetet një vendim juaji politik.

Për sa i përket Shkollës së Magjistraturës dhe vlerësimit profesional, unë jam shumë dembel për të bërë pyetjet. Në fakt, kjo ishte një nga pyetjet që doli këtu dhe nuk e shpika unë, nuk e bëj mbaj mend, në një diskutim që është bërë shumë kohë më parë se si mund të bëhet ky ekzaminim, ky provim që të gjithë personat duhet të shkojnë dhe ta bëjnë atë. Nëse e shikon, kjo është mënyra sesi një vlerësim duhet të bëhet dhe ju mund ta përshkruani më shumë sesi duhet të bëhet ky vlerësim. Mendoj se ky ishte një shqetësimet e vjetra që është ngritur dhe pak a shumë i është dhënë përgjigje nga drafti.

Ne u përpoqëm për të identifikuar dhe për t’iu përgjigjur disa prej shqetësimeve tuaja më kryesore. Edhe pse kjo listë nuk është ekskluzive, jemi përpjekur që në këtë letër të hidhnim ato pyetje që kishin të bënin me opsionin alternativ që ju vetë politikisht mund ta përzgjidhni; pra duhet të përzgjidhni një opsion pa shkelur standardet e Komisionit të Venecias. Tani ju keni mundësi ose keni disa subjekte, të cilat mund të jenë pjesë e vendimeve tuaja politike dhe ato që kanë propozuar ekspertët, që kanë propozuar tryezat e rumbullakëta duhet t’i merrni parasysh. Ju duhet t’i vlerësoni të gjitha alternativat që ne kemi dhënë.

Si diçka të përgjithshme, mund të them se kërkohen vite të tëra për zhvillimin e këtij sistemi, sepse po flasim për një sistem të tërë. Nuk po flasim vetëm për një gjykatë, por flasim për një sistem të tërë, i cili duhet dhe po përmirëson shumë aspektin e kontrollit dhe të balancës. Ky është një sistem i mirë. A mund ta ndryshoni ju këtë? Pyetja është: sa do ta ndryshoni. Mund të ndryshoni diçka këtu dhe, të ilustroni vetëm disa gjëra, nuk do të thotë që jeni duke ndryshuar të gjithë sistemin, por duke vendosur tani se prokurori i Përgjithshëm duhet të emërohet nga parlamenti dhe të zgjedhë anëtarët e SPAK-ut, sigurisht që edhe ky mund të jetë një ndryshim i sistemit. Pra, flasim një sistem i cili është propozuar dhe ju mund ta drejtoni në njëfarë mënyre. Nëse ju ndërhyri në elemente thelbësore, atëherë mund të flasim për një sistem që është i ndryshëm. Gjithashtu, në gjithë këtë gamë të gjerë pyetjesh harrova t’i përgjigjem një pyetjeje, të cilën ju e bëtë në lidhje me modelin kroat dhe atë të Maltës, që ju e përshkruat. Mendoj se esenca e pyetjes suaj është: persona, që do të përzgjidhen, a janë të përzgjedhur në mënyrë të dukshme politike dhe a do të funksionojnë ata në pozicionet e tyre në Këshillin e Drejtësisë, të cilët janë përzgjedhur në bazë të të

meritokracisë? Pra, ata janë atje, sepse duhet të jenë atje? Një parti politike apo një fraksion politik i zgjedhi që ata të jenë atje.

Një tjetër pikë që dua të them është se kjo është e drejtë, e arsyeshme brenda diskutimeve që janë bërë ndërmjet maxhorancës dhe opozitës se çfarë mund të jetë në një sistem që të funksionojë apo një sistem tjetër. Unë e thashë që në fillim: ndërkohë që ne mund të flasim për sisteme që janë brenda, pra sisteme që janë në kundërshtim me standardet e Komisionit të Venecias. Në fakt, këto janë dy sisteme që ekzistojnë në Europë. Me aq sa di unë, nuk ka ndonjë opinion, nuk janë kontrolluar nga Komisioni i Venecias. Kështu që ky Komision nuk është shprehur pro apo kundër këtyre dy modeleve, njësoj sikurse nuk duam ne të flasim dhe të përqendrohemi te SPAK, BKH-ja dhe veting, procesi i vlerësimit, sepse e thjeshton vetëm një anë të pozicionit dhe përfshin, gjithashtu, vendimet politike. Unë mendoj se për ne nuk do të ishte e përshtatshme, të jepnim vendimet tona për diçka që nuk e ka bazën në Komisionin e Venecias,

Sigurisht, ka modele në Europë, të cilat mund të ndikohen nga vendimet politike që ju mund t'i merrni këtu. Ndërkohë, ne e kemi shprehur se ky është një proces, i cili është i ndryshëm kur bazohet në meritokraci, por ai zgjedh që të njohë një realitet politik brenda sistemit. Kjo gjë është e vërtetë! Ne nuk mund të flasim për këtë gjë pa shkuar përtej ekuilibrave apo balancave tona, si përfaqësues të misioneve ndërkombëtare.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në bazë të misioneve tuaja, sepse po të ishte për këtë gjë, mjaftojmë vetë këtu që ta ngatërronim më së miri, por ne prandaj ju kemi kërkuar, që t'i rrini strikt gjykimin të ekspertit dhe në rastin tuaj, si ekspert ndërkombëtar, të përputhshmërisë së gjithë këtij projekti dhe të gjithë çështjeve të diskutuara, me standardet më të mira ndërkombëtare të fushave përkatëse. Për këtë ju jeni shumë të domosdoshëm, prandaj jeni këtu dhe ne ju vlerësojmë.

Për sa u përket çështjeve që kanë të bëjmë për atë që ju thatë: “Mund ta merrni kështu apo mund ta merrni ashtu”, ne duam ta marrim vetëm ashtu siç e ka thënë Komisioni i Venecias, sepse kemi rënë dakord, që i gjithë shtrati mbi të cilin do të ndërtohet procesi janë rekomandimet e opinionit final të Komisionit të Venecias.

Pastaj për çështje që janë të diskutueshme që dhe opinionin i “Venecias” është shprehur qartazi, edhe ju i theksuat këtu, edhe ne ndajmë të njëjtin vlerësim, që ka nevojë për një debat dhe vendimmarrje politike, pa dyshim që do të ketë një proces të kësaj natyre. Gjithsesi dhe në atë rast mendoj se ato janë çështje që vërtet kanë nevojë për vendimmarrje politike, por zgjidhjet janë teknike dhe zgjidhjet teknike janë disa. Kontributi juaj deri në

nivelin teknik mbetet i mirëpritur edhe në çështjet e këtyre natyrave, që besoj se shumë shpejt do të duhet të ballafaqohemi.

Në rregull.

Ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera.

Faleminderit!

Mendoj se bëmë përpara një hap shumë pozitiv! Tashmë, ne kemi disa dokumente në dispozicion: kemi projektin kushtetues, kemi opinionin final të Komisionit të Venecias, kemi një debat parlamentar, i cili ka ngritur njëkohësisht disa pyetje dhe ka bërë disa komente, rreth të cilave kemi një qëndrim të ekspertizës ndërkombëtare. Këto janë hapa shumë të mirë përpara, përfshirë edhe paraqitjen e këtij dokumenti nga ana juaj, i cili tashmë është në dispozicion të të gjithë anëtarëve të komisionit të posaçëm parlamentar, të atyre që janë përfaqësues të maxhorancës dhe të atyre që janë përfaqësues të opozitës, pavarësisht se ndenjësjet e karriges i kanë bosh në mbledhjen e sotme, por janë të njohur me përmbajtjen e këtij dokumenti të përgatitur nga ana juaj, ashtu siç kanë dhe gjithë mundësinë që t'i referohen edhe procesverbalit të mbledhjes së komisionit.

Dëshiroj t'ju falënderoj përzemërsisht, edhe në emër të kolegëve, për angazhimin tuaj, përgjegjshmërinë dhe përkushtimin e treguar me të cilin jeni duke e bërë këtë detyrë! Natyrisht, ju i shërbeni punës suaj, por në një kuptim tjetër edhe për këtë ju falënderojmë; jeni duke na dhënë ne një mbështetje shumë të rëndësishme për të ecur përpara në këtë proces. Ne ju jemi mirënjohës dhe do t'ju jemi më shumë mirënjohës, nëse do të vazhdojmë të ecim akoma më përpara, sepse mirënjohja nga ne, si individë, do të kalojë në një mirënjohje, që është mirënjohja e qytetarëve të këtij vendi!

Gjithsesi, për të ecur përpara, kemi nevojë të bëjmë disa hapa të tjerë:

Së pari, në një reagim tuajin jam njohur me faktin se ju keni një dokument lidhur me gjuhën apo terminologjinë e mundshme, që mund të merret në konsideratë nga komisioni i posaçëm për të adoptuar opinionin e Komisionit të Venecias, nëse ju e keni finalizuar dhe e çmoni të nevojshme duke menduar që mund të na hyjë në punë gjatë debatit, do ta vlerësonim nëse do ta kishim. Në rast se çmoni që ai është një dokument që do ta përdorni brenda jush, nuk kemi pse insistojmë. Mund të mbetet edhe kështu. Megjithatë, nëse e çmoni të arsyeshme, mund të na i vendosni në dispozicion.

Së dyti, ka ardhur momenti të hyjmë te dispozitat kushtetuese, te projektet kushtetuese.

Kemi ezauruar gjithë debatin mbi këndvështrimet e ndryshme që kemi për çështje të caktuara. Kemi njohur edhe opinionet përkatëse, dhe tani është momenti për t'i reflektuar në draftin kushtetues.

Për ta bërë këtë, kemi dy dokumente. Nga njëra anë kemi opinionin e Komisionit të Venecias, i cili ka rekomanduar për disa ndërhyrje të natyrës teknike, ku është vendosur theksi se ku duhet të ndërhyjë projekti kushtetues për të përmirësuar nene të caktuara.

Detyra juaj e parë është që t'i reflektoni këto! Pra, të reflektoni rekomandimet, sugjerimet konkrete të natyrës teknike që ka dhënë Komisioni i Venecias për t'u pasqyruar në projektin kushtetues.

Nga ana tjetër, kemi edhe komentet, debatet e bëra në këtë komision parlamentar, që kanë marrë edhe vlerësimin tuaj si ekspertë të pranuar nga të dyja krahët, duke ju njohur si ekspertë që do të jepni gjykimin teknik rreth çështjeve të debatuarat prej nesh.

Në këtë kontekst, kemi edhe këtë burim gjetjesh apo qasje për çështjet e debatuarat. Mbi bazën e këtyre dy dokumenteve, do të dëshironim t'i shihnim të reflektuarat, të ndryshuarat në projektin kushtetues.

E thënë shkurt, kërkojmë të kalojmë në hapin tjetër, në reflektimin e debatit dhe të rekomandimeve të opinionit final të Komisionit të Venecias në nenet përkatëse kushtetuese.

Ju keni punuar rreth kësaj dhe i keni dhënë kohë vetes gjatë gjithë këtyre tensioneve politike, turbulencave, të cilat kanë krijuar ditë të gjata pushimesh që të mund të punoni mbi këtë projekt. Sikurse e keni paraqitur, projektin e keni konsultuar edhe me ekspertët e nivelit të lartë, të cilët janë angazhuar përgjatë një viti e gjysmë me shumë përkushtim dhe përgjegjësi, dhe gjej rastin për t'i falënderuar për hartimin e këtij projekti, si edhe me ekspertë të opozitës, të cilët janë angazhuar me kërkesë të opozitës në këtë proces.

Nëse këtë dokument mund ta kemi brenda ditës së mërkurë për t'ju shpërndarë anëtarëve të komisionit të posaçëm parlamentar, në mënyrë që të përgatiten për diskutimin mbi nenet kushtetuese, kjo do të ishte diçka shumë pozitive. Natyrisht, nëse do t'ju duhet kohë më tepër, na vini në dijeni. Gjithsesi, dita e mërkurë është e favorshme për ne që t'ju japim mundësinë të keni kohën e nevojshme për t'u njohur me projektin kushtetues.

Në fund, besoj se stafi do të kujdeset për procesverbalin e kësaj mbledhjeje që të vihet në dispozicionin e të gjithë anëtarëve të komisionit të posaçëm.

Natyrisht, nuk kishte diçka përtej dokumentit të paraqitur nga ana juaj, por gjithsesi meqenëse u bënë dhe disa pyetje, pati edhe përgjigje, të cilat do të reflektohen në proces verbal i cili është pjesë e dokumenteve të rëndësishëm që do të shërbejë për hapat e mëtejshëm të diskutimeve në komision.

Rainer Deville - Ju sigurojmë që kemi mundësinë të flasim edhe me ekspertët e tjerë të lartë për ta ofruar materialin ditën e enjte nëse është e mundur.

Fatmir Xhafaj - E quaj shumë të arsyeshme këtë gjë.

Këtu e mbyllim për t'u njohur më pas me projektin kushtetues të reflektuar mbi këtë debat dhe opinionin final të Komisionit të Venecias, dhe për të kaluar në shqyrtimin e këtij projekti në mbledhjet e radhës të komisionit të posaçëm parlamentar, për datën e të cilës do t'ju njoftojmë ditët në vijim.

Faleminderit zoti Deville, faleminderit zoti Smibert, faleminderit ekipit që ju asiston me shumë përkushtim, për të cilin kemi respekt të veçantë, faleminderit edhe stafit tonë nën drejtimin e Sekretares së Përgjithshme, faleminderit zonjave përkthyesë dhe ekipit që do të bëjë të mundur që procesverbali të jetë i regjistruar! Faleminderit kolegëve!

Me kaq e mbyllim. Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë